

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryetare e kolegjit, Erdogan Haxhibeqiri dhe Jelena Krivokapiq, anëtar,në çështjen juridike të paditësit H. O., nga ...,të cilin me autorizim e përfaqëson Av.I. Q., nga ..., kundër të paditurës Komuna e Ferizajt-Drejtoria e Arsimit, për pagesën e tri pagave përcjellëse për pension, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr. 5570/2018 datë 06.03.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur më 25.06.2019, mori këtë:

#### A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit në Prishtinë KMLC.nr.54/2019, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr. 5570/2018 datë 06.03.2019.

#### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr. 5570/2018 datë 06.03.2019, refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Ferizajt-Drejtoria e Arsimit dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.551/2018 datë 18.07.2018, me të cilin pjesërisht është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, ashtu që në pjesën I të dispozitivit, është detyruar e paditura që paditësit H. O. nga ..., në emër të shpërblimit për tri paga përcjellëse me rastin e pensionimit t'ia paguaj paditësit shumën prej 926.39 €, me kamatë ligjore prej 8%, nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e pasojave juridike. Në pikën II të dispozitivit është refuzuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit përtej shumave të aprovuara në pjesën I të dispozitivit, në shumë prej 242.38€ si të pa bazuar, ndërsa në pikën III të dispozitivit është detyruar e paditura që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës është obliguar e paditura t'ia kompensoj paditësit shpenzimet e procedurës dhe ate: për paraqitjen e padisë në gjykatë shumën prej 30 € si dhe shpenzimet për përpilimin e padisë në shumë prej 104€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë se aktgjykimit, nën kërcënimin e pasojave juridike.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, Prokurori i Shtetit ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 247 par.1 pika a, lidhur me nenin 182 par.2 pika h; neni 247 par.1 dhe

zbatimit të gabuar të drejtës materiale, përkatësisht pika b të nenit 247 par.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK ).

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të kundërshtuar sipas nenit 251 të LPK, ka gjetur se:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi ka qenë i punësuar te e paditura në pozitën mësues klase në Shkollën Fillore e Mesme e Ultë “Abetarja”, në paralelen e ndarë në fshatin Pajatë, sipas kontratës së punës nr.1745 të datës 31.03.2015 dhe se me vërtetimin e të paditurës- Shkolla Fillore “Arbërija” me nr. 2506 të datës 12.12.2016, është konstatuar se paditësi ka punuar te e paditura që nga data 05.03.2014 deri më 10.11.2016. Paditësi i pakënaqur me vendimin e Drejtorisë së Arsimit në Ferizaj me të cilin i është refuzuar e kërkesa në 3 (tri) paga përcjellëse duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit Para universitar dt. 11.04.2014, brenda afatit ligjor i është drejtuar gjykatës me padi për realizimin e kësaj të drejte. Lartësinë e kërkesëpadiisë paditësi e ka mbështetur në bazë të raportit të Raiffeisen Bank të datës 05.12.2016, ku paga mujore neto e paditësit në tre muajt e fundit para shkuarjes në pension ka qenë 926.39 € e jo siç pretendon paditësi në padi në shumë prej 1,167.77€.

Në një gjendje faktike të vërtetuar kësisoj, gjykata e shkallës së parë pas administrimit ë provave dhe vlerësimit të tyre , ka gjetur se kërkesëpadiia e paditësit është e bazuar në nenin 35 par.9 të Kontratës Kolektive në Arsim e datës 18.04.2017, e cila me hyrjen në fuqi ka shfuqizuar kontratën Kolektive e Arsimit Parauniversitar të datës 11.04.2014, ndërsa paditësi ka dalë në pension me datë 10.11.2016, çka do të thotë se Kontrata në fjalë ka qenë në fuqi në momentin e pensionimit të paditësit dhe se e njëjta është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 të Ligjit të Punës, nga edhe rrjedh themelësia e kërkesëpadiisë.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën e ankimit ka aprovuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm dhe ka refuzuar si të pa themeltë ankesën e të paditurës Komuna e Ferizajt- Drejtoria e Arsimit ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike, ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët në mbështetje të gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të

drejtë dhe të plotë, drejt kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë vendosur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat Prokurori i Shtetit thirret në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, njëkohësisht nuk përmban të meta që kishin me ndikuar në ligjshmërinë e saj lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk qëndron pretendimi Prokurorit të Shtetit se gjykata e shkallës së parë është marr me shkelje thelbësore të dispozitave të LPK-së me rastin e marrjes së vendimit gjyqësor pa mbajtur shqyrtim gjyqësor, vërtetuar edhe me vendimin e gjykatës së shkallës së dytë, për faktin se gjykata e shkallës së parë pas pranimit të përgjigjes në padi, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 152 të LPK-së, me të cilin dispozitë ligjore përcaktohet se “*po qëse i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadiës, gjykata mundet pa caktuar seancë gjyqësore të jap aktgjykim*”. Duke ju referuar kësaj dispozite ligjore, është fakt i pa kontestueshëm se paditësi ka punuar te e paditura si mësues që nga data 15.03.2014 deri më 10.11.2016, po ashtu jo kontestuese fakti se i njëjti për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare ka plotësuar kushtet për pension, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadiës nga ana e të paditurës se pagat përcjellëse u takojnë vetëm anëtarëve të SBASHK-ut, sipas dispozitës së nenit 35 pika 9 të Kontratës Kolektive të Kosovës dt. 18.04.2017. Gjykata duke pasur parasysh faktin se e paditura i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadiës, drejt ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit gjyqësor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara.

Po ashtu, nuk qëndrojnë as pretendimet e Prokurorit të Shtetit se pagat përcjellëse të të punësuarve në sektorin e arsimit mund t'i gëzojnë vetëm anëtarët e organizatës sindikale bazuar dispozitën e nenit 35.9 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të dt. 18.04.2017, ku theksohet se: “*punëtorët (anëtar të SBASHK-ut), që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi në e tri pagave sipas mesatarës së tri pagave të fundit të punëtorit*”, bazuar në faktin se SBASHK-u, as për antarët e vet të sindikatës e as punonjësit të tjerë si në rastin konkret nuk ndan mjete nga fondi i saj për paga jubilarë dhe përcjellëse gjatë pensionimit, por se këto mjete ndahen nga Buxheti i Komunave, andaj një kontestim i tillë bie ndesh me dispozitat ligjore në fuqi që garantojnë status të barabartë të të punësuarve si në sektorin publik po ashtu dhe në ate privat në Kosovë, e në veçanti me nenin 4 të Statutit të BSPK-së ku thuhet se “*BSPK-ja ushtron veprimtarinë e saj për një shoqëri në të cilën të gjithë të punësuarit dhe qytetarët, do të gëzojnë të drejtë në punë dhe*

*jetë dinitoze, realizimin dhe mbrojtjen e interesave ekonomike, sociale, edukative dhe kulturore e në veçanti a) respektimin e të drejtave të të punësuarve...”*

Me dispozitën e nenit 2 të Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-212 i 1 dhjetorit 2010 ( i cili ligj ka qenë në fuqi në kohën e pensionimit të paditësit), është paraparë se dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikës e Kosovës. Në nenin 3 janë përcaktuar përkufizimet për shprehjet e përdorura në këtë ligj , në pika 1.3 është paraparë që në sektorin publik përfshihet sektori arsimit, së shëndetësisë si dhe ndërmarrjet publike të cilat janë pronësi e Republikës së Kosovës apo ndonjëres nga komunat e republikës së Kosovës. Me dispozitat e këtij ligji nuk është paraparë e drejta e punëtorit të pensionuar në realizimin e të drejtës në pagesën në emër të shpërblimit jubilar dhe pagesën përcjellëse për shkuarje në pension. Me dispozitën e nenit 77 po të njëjtut ligj është paraparë që pensioni i vjetërsisë dhe i parakohshëm rregullohen me ligj të veçantë.

Parashtrimet në revizion se, aktgjykimet e të dy gjykatave janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore kjo Gjykatë i vlerësoi si të paqëndrueshme për faktin se aktgjykimet e të dy gjykatave, nuk janë të përfshira me këto shkelje dhe të dy gjykatat kanë vlerësuar faktet relevante për vendosjen e drejtë të kësaj çështjeje juridike lidhur dhe përmbajnë arsye faktike dhe juridike për të gjitha faktet relevante e që janë të pranueshme edhe për këtë Gjykatë.

Nga sa u tha më lartë e me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

CML.nr.6/2019, më 25.06.2019

Kryetare e kolegjit,

Gyltene Sylejmani